

## Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët memorandum bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë




Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët nënkroi memorandum bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Nënkrimi i këtij Memorandumi u krye nga kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, prof. Skënder Gjinushi, drejtoresha ekzekutive e QSPA-së, prof. Diana Kastrati si dhe Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko. Ky Memorandum synon koordinimin e studimeve për kulturën dhe historinë e komunitetit arbëresh, bashkëpunimin ndërinstitucional që parashikon realizimin e studimeve të përbashkëta mbi historinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh, organizimin e aktiviteteve studimore si dhe krijimin e grupeve të punës për aplikimin në projekte të përbashkëta. Pikë me rëndësi është edhe mbështetja e studiuesve të rinj, të cilët do të realizojnë studime dhe publikime për këtë komunitet. Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, e krijuar së fundmi, është institucioni i parë në historinë e shtetit shqiptar që ka fokus ekskluziv studimet e specializuara që ngërthejnë gjithë universin kulturor, historik, letrar, sociale dhe antropologjik të komunitetit arbëresh, si një trashëgimi unikale kulturore në mbarë botën.

## Emërohet Drejtorja Ekzekutive e Agjencisë Kombëtare të Diasporës



Znj. Sonila Hysi Ruka është emëruar drejtoreshë ekzekutive e Agjencisë Kombëtare të Diasporës. Ajo është diplomuar në Financë në State University of New York/Empire State College, në vitin 2009. Ka përfunduar studimet në nivelin Master për "Administrim Biznesi" pranë "Institut Universitaire Kurt Bösch" në Zvicër në vitin 2013. Kandidatë për PhD pranë Sofia University "St. Kliment Ohridski". Znj. Ruka i është bashkëlidhur administratës publike në vitin 2014. Para marrjes së detyrës si Drejtoreshë Ekzekutive e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, ka punuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në pozicionin drejtues si Përgjegjëse për Menaxhimin Financiar të ndihmës së BE-së në Republikën e Shqipërisë.

## Qendra e Botimeve për Diasporën, mbledhje online me drejtuesit e lidhjeve të mësuesve në diasporë



Qendra e Botimeve për Diasporën në kuadër të marrjes së informacionit dhe zgjidhjes së problematikave të lindura nga situata e re e krijuar me shkollat shqipe në diasporë prej gjendjes së pandemisë globale, ka ndërmarrë një seri mbledhjesh online me drejtuesit e lidhjeve të mësuesve në diasporë. Në datën 6 maj, u zhvillua mbledhja me përfaqësues të lidhjes së mësuesve të Italisë, nën drejtimin e znj. Ariana Kosova dhe përfaqësues të Qendrës së Botimeve për Diasporën, nën drejtimin e znj. Mimoza Hysa. Botimeve për Diasporën, nën drejtimin e znj. Mimoza Hysa. Sipas rendit të ditës u diskutua mbi mënyrën e organizimit të mësimit të gjuhës shqipe në Itali dhe ndërgjegjësimin e institucioneve shtetërore të vendit të origjinës dhe vendit pritës për krijimin e kushteve me ambiente të përshtatshme pranë shkollave ekzistuese italiane.

## KKD / Lazim Destani, nismë humanitare në Kosovë

Lazim Destani, anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës dhe njëkohësisht Presidenti i Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare, dhuron pajisje elektronike për t'u mundësuar ndjekjen e mësimit online nxënësve të familjeve në nevojë në Kosovë. Sa i përket kësaj nisme, Destani është shprehur: "Arsimi dhe shkencat janë pistonët kryesorë të një shoqërie, investimet dhe mbështetjet e këtyre segmenteve janë mbështetja më e madhe që mund t'i bësh një kombi. Andaj vendosëm që këtë donacion t'u dedikojmë nxënësve që për shkak të mungesës së pajisjeve të nevojshme teknologjike mbetën jashtë procesit arsimor. Digjitalizimi është gjithashtu një proces i pashmangshëm i një shoqërie, andaj edhe donacionin e shohim me kuptim afatgjatë".




## KKD / Gazmend Kapllani pjesë e diskutimit virtual me fokus Diasporën



Aleanca Kulturore Shqiptaro-Amerikane në Universitetin DePaul në Chicago do të organizojë një seri aktiviteteve online. Lajmi është bërë i ditur nga anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës, Gazmend Kapllani, i cili thotë se si pjesë e kësaj veprimtarie do të jetë shfaqja e dokumentarit "Anija" (La Nave) e regjisorit shqiptar Roland Sejko, i cili përshkruan flukset e migracionit shqiptar në fillim të viteve '90. Më tej, thuhet se shfaqja e dokumentarit do të vijohet me një panel diskutimi, pjesë e të cilit do të jetë vetë Kapllani si dhe përfaqësues të tjerë të Diasporës shqiptare në SHBA.

## Aplikacioni informues "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

## Aplikacioni gazeta "Diaspora Shqiptare"

SHKARKO APLIKACIONIN FALAS



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

## "Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

## KKD / Adriana Fishta-Bejko intervistë me mjekun shqiptar



Anëtarja e Këshillit Koordinues të Diasporës, Dr. Adriana Fishta-Bejko, interviston mjekun shqiptar Bernard Meshi, në Calgary të Kanadasë. Dr. Meshi tregon për zhvendosjen drejt Kanadasë në vitin 1997 dhe rrugëtimin e tij profesional. Gjithashtu, mjeku jep disa këshilla të rëndësishme për bashkëkombasit si edhe thekson disa nga masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së COVID-19.